

## KONTRATË PËR SHITBLERJE KUOTASH

Sot, me 30/08/2022, në Tiranë, lidhet mes palëve të mëposhtëme kjo kontratë për shitblerje kuotash (me poshtë referuar si “Kontrata”):

**Znj. Enila Hasani**, e bija e Ilmi dhe Engjellushe, e datëlindjes 26.03.1979, lindur në Tepelenë dhe banuese në Tiranë, në Adresën Rr: “Brigada VIII”, Pallati Nr.19, Hyrja 4, identifikuar me ID me Nr. 036785085 dhe Nr. Personal H95326192L, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e ortakes të shoqërisë “SummerSun” SH.P.K

(me poshte referuar si “Shitësi”);

dhe

**Z. Fatjon Mahmudaj**, i biri i Urim dhe Jalldiz, i datëlindjes 01.12.1965, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, në Adresën: “Margarita Tutulani”, ish Banka e Kursimeve, Kati 6, Ap. 17, i identifikuar me ID me Nr. 036787737 dhe Nr. Personal G51201100H, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, gjithashtu në cilësinë e ortakut të shoqërisë “SummerSun” SH.P.K (më poshtë referuar si “Blerësi”);

Shitësi dhe Blerësi referohen më poshtë veçmas si “Pala” ose bashkarisht si “Palët”.

### KUSHTE PARAPRAKE

- A. Duke qenë se Shoqëria “SummerSun” Shpk, është një person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NIPT M21803037R, me seli në Rr. *Margarita Tutulani, Pallati Ish-Bankës së Kursimeve, Kati 6, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri* (më poshtë Shoqëria).
- B. Shitësi është Ortak që zotëron një kuotë të barazvlefshme me 40% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, i cili përbëhet prej 40 kuotave prej 400.000 (katërqind mijë) LEKË.
- C. Duke qenë se Shitësi ka për qëllim t’i shesë Blerësit i cili është po ashtu ortak në të njëjtën shoqëri dhe Blerësi ka për qëllim t’i blejë Shitësit 100% (njëqind përqind) të kuotave që Shitësi ka në pronësi në Shoqëri me çmimin e përcaktuar më poshtë, sipas modaliteteve të kësaj kontrate. (“Kuotat në Shitje”);

*Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:*

Neni 1

Shitja e Kuotave

- 1.1 Sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë, Shitësi i shet Blerësit dhe Blerësi i blen Shitësit, Kuotat në Datën e Nënshkrimit, të lira nga çdo Barrë, me Çmimin e Blerjes për t'u paguar në mënyrën e përshkruar në nenin 3.
- 1.2 Blerësi fiton pronësinë mbi Kuotat, dhe të gjitha të drejtat e lidhura me pronësinë mbi Kuotat në Shitje, në Datën e Nënshkrimit të kësaj Kontrate. Blerësit i lind e drejta në Datën e Nënshkrimit të kësaj Kontrate të regjistrojë pronësinë e tij mbi Kuotat në Shitje duke paraqitur këtë kontratë në QKR, në librat e Shoqërisë dhe në çdo organ tjetër kompetent.
- 1.3 Blerësi ka të drejtë që me nënshkrimin e kontratës, të depozitojë dhe të regjistrojë këtë të fundit në QKR, duke bërë në këtë mënyrë kalim e pronësisë mbi kuotat në shitje në favor të Blerësit.

## Neni 2

### Çmimi i Blerjes

- 2.1 Çmimi i Blerjes për Kuotat në Shitje është në total 400.000 (katërqind mijë) LEKË (“Çmimi i Blerjes”).
- 2.2 Ky çmim përfshin dhe merr parasysh gjëndjen aktuale ekonomike dhe pasurore të Shoqërisë për të cilën Blerësi është në dijeni, dhe ky i fundit deklaron se nuk ka asnjë arsye kundërshtimi.
- 2.3 Çmimi i Blerjes do t'i paguhet Shitësit me këste, brenda një afati prej 10 muajsh nga Data e nënshkrimit të kësaj kontrate, specifikisht deri më datë 30 Qershor 2023.
- 2.4 Përveç çmimit të përcaktuar në nenin 3.1, Shitësi do të përfitojë dividend për periudhen nga data 01.06.2022 deri në datën 31.12.2022, proporcionalisht me dividendin e deklaruar nga shoqëria në fund të vitit financiar 2022.
- 2.5 Pagesa do të bëhet nepërmjet transfertave bankare në llogarinë personale të Ortakut Enila Hasani, me te dhenat specifike sipas vertetimit bankar bashkelidhur kësaj kontrate.
- 2.6 Palët bien dakort që çdo tarifë bankare që mund të bëhet i kërkueshëm nga banka për transfertat e vlerave të mësipërme do të jetë në ngarkim të Shitësit.

## Neni 3

### Mbyllja dhe Kushti i Mbylljes

- 3.1 Palët bien dakort që kjo Kontratë është një marrëveshje me kusht duke qënë se çmimi i shitjes nuk do të paguhet në momentin e nënshkrimit të kontratës. Pavarësisht sa më sipër, palët bien dakort që kjo kontratë është detyruese për palët në lidhje me transaksionin e përcaktuar aty dhe se asnjëra prej palëve nuk mund të ndryshojë pa miratimin e palës tjetër, elemente të rëndësishëm të saj siç janë çmimi, detyrimi për të shitur kuotat dhe detyrimi për ti blerë me çmimin e caktuar.
- 3.2 Mbyllja ndodh ditën që Blerësi kryen pagesën e plotë të Çmimit të Blerjes. Gjithashtu nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate e deri në datën e Mbylljes Blerësi do të ushtrojë të tëra të drejtat e votës që i përkasin kuotave në shitje, dhe Shitësi nuk do të ketë asnjë vendimarrje



- në Shoqëri. Palët kanë lidhur këtë marrëveshje duke qenë të bindur se kjo kontratë është e detyrueshme për ta në lidhje me të drejtën e përfitimit të kuotave kundrejt çmimit të paguar dhe anasjelltas që këto kuotave kanë vlerën e përcaktuar në këtë Kontratë ndonëse nuk paguhen tërësisht në momentin e nënshkrimit të kontrates dhe se kjo vlerë do të jetë e ndryshueshme deri momentin e kryerjes së pagesës përfundimtare.
- 3.3 Palët bien dakord se mospërmbushja e detyrimit nga ana e Blerësit lidhur me pagesën e cmimit të plotë të përcaktuar në këtë kontratë brenda afateve të specifikuara në nenin 2.3 i kthen palët në gjendjen e tyre fillestare.

#### Neni 4

#### Deklarimet dhe Garancite e Shitësit

Shitësi me anë të kësaj Kontrate deklaron dhe garanton në lidhje me Shoqërinë si dhe me Transaksionin që parashikohet në këtë Kontratë, për të gjitha çështjet që vijnë, në Datën e Nënshkrimit.

#### 4.1. ORGANIZIMI

Shoqëria është krijuar dhe themeluar rregullisht sipas ligjeve shqiptare, nuk është në gjendje paaftësie paguese apo në falimentim, dhe ka fuqi të plotë dhe kompetenca për të kryer aktivitetin e saj siç i kryen aktualisht.

#### 4.2. AUTORIZIMI

Të gjitha aktet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar ose statuti i Shoqërisë që duhet të ndërmerren nga ose për llogari të Shitësit dhe që autorizojnë Shitësin të lidhë dhe të zbatojë këtë Kontratë janë kryer rregullisht. Kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga Shitësi dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv për Shitësin dhe që duhet zbatuar prej tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e Kontratës.

#### 4.3. PRONËSIA

Shitësi është pronar dhe përfitues i vetëm dhe i ligjshëm i të gjithë Kuotave në Shitje.

Kuotat në Shitje janë të lira dhe të çliruara nga çdo Barrë e çfarëdo lloji dhe Shitësi ka të gjitha të drejtat, kompetencat dhe autorizimin e plotë për t'i shitur, për t'i kaluar, transferuar dhe dorëzuar Kuotat në Shitje në përputhje me afatet e kësaj Kontrate.

Nuk ka asnjë kontratë, marrëveshje, ose detyrim që krijon ose vendos ndonjë Barrë në lidhje me Kuotat në Shitje. Asnjë person nuk pretendon se ka ndonjë drejtë mbi ndonjë Barrë lidhur me ndonjë nga Kuotat në Shitje.

Përveç kësaj Kontrate, nuk ka asnjë kontratë, marrëveshje, ose detyrim që parashikon krijimin, dhënien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin e, ose dhënien e së drejtës një personi (të kushtëzuar ose jo) për të kërkuar dhënien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin e ndonjë kuote të kapitalit të Shoqërisë (që përfshin, por pa u kufizuar në, një preferencë - të drejtën për të ofruar i pari -, ose të drejtën e parablerjes ose këmbim).

## Neni 5

### Të Drejtat dhe Detyrimet e Palëve

- 5.1 Blerësi gjatë kësaj periudhe ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e votës në lidhje me këto Kuota për marrjen e çdo vendimi të nevojshëm për shoqërinë si dhe për marrjen e vendimeve për shitjen tek të tretët të Kuotave që do të kalojnë në pronësi të tij me nënshkrimin të kësaj kontrate.
- 5.2 Në rast se çmimi i shitjes dhe detyrimet e tjera të parashikuara në nenin 6.3 të kësaj kontrate nuk janë shlyer ende, palët kthehen në gjendjen e tyre të mëparshme dhe shitësi disponon kuotat e tij me të drejta te plota, sikur kjo kontratë mos të ishte lidhur asnjëherë mes tyre.
- 5.3 Blerësi deri në përfundim të afatit të përcaktuar për shlyerjen totale të detyrimit/çmimit të blerjes, do të ushtrojë të drejtën e votës për këto kuota ne shoqëri pa miratimin paraprak të palës shitëse.

## Neni 6

### Dëmshpërblimi nga Shitësi dhe Blerësi

- 2.1 Shitësi duhet të dëmshpërblej dhe të mbaj të padëmtuar Blerësin dhe/ose Shoqërinë për çdo Humbje tani dhe në të ardhmen që rrjedh ose varet direkt ose indirekt nga çdo veprim lidhur me fakte ose rrethana që kanë të bëjnë me titullin e pronësisë mbi kuotat dhe të drejtat e tij mbi to, të krijuara apo që kanë ndodhur para Datës së Nënshkrimit, ose edhe pas kësaj date e që prekin të drejtat e Shitësit sipas kësaj kontrate.

## Neni 7

### Vlefshmëria e pavarur e dispozitave

- 2.1 Në rast se një klauzolë ose një dispozitë sipas kësaj Kontrate është, për çfarëdolloj arsyeje, e pavlefshme, e paligjshme, ose e pazbatueshme në çfarëdolloj aspekti, kjo pavlefshmëri, paligjshmëri dhe pazbatueshmëri e këtyre klauzolave ose dispozitave nuk do prekë asnjë klauzolë ose dispozitë të kësaj Kontrate dhe kjo Kontratë do të interpretohet dhe kuptohet sikur kjo klauzolë ose dispozitë, në masën në të cilën është e pavlefshme, e paligjshme, ose e pazbatueshme, nuk ka qenë asnjëherë pjesë e Kontratës, megjithatë, kjo pavlefshmëri, paligjshmëri, ose pazbatueshmëri nuk do të sjellë ndryshime materiale të Kontratës. Kjo do të thotë, që në çdo rast, palët e kanë shprehur vullnetin e tyre për të kryer transaksionin objekt i kësaj kontrate, pra shit-bletjen e kuotave në shitje kundrejt çmimit të treguar në këtë kontratë dhe se marrin përsipër të kryejnë çdo veprim dhe ose të nënshkruajnë çdo dokument të nevojshëm për të realizuar qëllimin që i çoi ata në lidhje e kontratës ose shprehjen e vullnetit të tyre të plotë në lidhje me sa më sipër.

## Neni 8

### Ligji i Zbatueshem

- 8.1 Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

- 8.2 Çdo ndryshim i saj do të bëhet me shkrim dhe forma e thjeshtë shkresore me nënshkrimin e të dy palëve është forma për të cilën palët kanë rënë dakort të ketë vlerë të plotë për të vërtetuar vullnetin e tyre.
- 8.3 Kjo kontratë dhe çdo ndryshimi saj ka fuqi të plotë ndaj palëve dhe çdo trashëgimtari të tyre duke përbërë titull detyrimi për sa ajo paraqet në të. Kjo kontratë nuk mund të transferohet apo ti kalohet ndonjë të treti pa miratimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

#### Neni 9

#### Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 2.1 Çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë, duke përfshirë por pa u kufizuar në interpretimin, pavlefshmërinë, mospërmbushjen ose zgjidhjen e saj, si edhe mosmarrëveshjet për mbushjen e hapësirave të Kontratës ose përshtatjen e saj me lindjen e rrethanave të reja, do të zgjidhet me mirëkuptim mes palëve, në rast se palët nuk gjejnë një zgjidhje të përbashkët, do ti drejtohen për zgjidhje Ndërmjetësit. Vetëm në rast se procedura e Ndërmjetësimit mes palëve dështon, atëherë këta të fundit për zgjidhjen e konflikteve të tyre do t'i referohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### Neni 10

#### Mënyra e Njoftimit


- 10.1 Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, një njoftim sipas kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm vetëm nëse është bërë me shkrim e dorëzohet personalisht ose me ane të postës elektronike.
- 10.2 Njoftimet sipas kësaj Kontrate do t'i dergohen Palës së kësaj Kontrate në adresen ose numrin e saj, dhe për dijeninë e individëve, parashikuar si më poshtë:

**Shitësi**

**Blerësi**

Znj. Enila Hasani

Rr. Brigada 8,  
Nd.19, Ap.1  
Tiranë Shqipëri

Z. Fatjon Mahmudaj  
  
Rr. "Margarita Tutulani"  
Kati 6, Ap. 17  
Tiranë Shqipëri

#### Neni 11

#### Kostot dhe Shpenzimet

- 10.1 Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, Palët bien dakord se Blerësi do të përballojë të gjitha kostot dhe shpenzimet në lidhje me negociatat, përgatitjet, zbatimin dhe hyrjen në fuqi të Kontratës dhe të gjithë dokumentat e tjera të përmendura në këtë Kontratë.



Neni 12  
Nënshkrimi

- 12.1 Kjo Kontratë është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale në shqip me të njejtën vlerë ligjore dhe është nënshkruar nga Palët.
- 12.2 Shitësi dhe Blerësi bien dakord që me kërkesën e parë të Palës tjetër dhe/ose Shoqërisë, të nënshkruajnë dhe të lëshojnë çdo dokument të nevojshëm dhe në përgjithësi të bëjnë çdo gjë që është e nevojshme që transferimi i pronësisë mbi Kuotat në Shitje sipas kësaj Kontrate, të regjistrohet pranë QKR-së, si edhe pranë çdo autoriteti tjetër shqiptar, në Datën e Nënshkrimit.

\* \* \* \*

**SHITËSI**

Znj. Enila HASANI



**BLERËSI**

Z. Fatjon Mahmudaj

